



Republika e Kosovës

Qeveria

Ministria e Shëndetësisë

Departamenti shëndetësor i burgjeve

**Raporti i gjashtë mujorit të parë të punës së Departamentit
Shëndetësor të Burgjeve për vitin 2017**

Përpiluar nga:

Dr. Milazim H. GJOCAJ, Dr. Sci

Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve

Korrik, 2017
Në Prishtinë

Përmbajtja e raportit:

HYRJE	3
I. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje	3
1. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së kujdesit shëndetësor	3
2. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mjekësor të burgjeve	3
3. Kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm për të gjithë të burgosurit pa dallim në nivel të njëjtë sikur për qytetaret e tjerë në sistemin publik shëndetësor	4
4. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe kuantitative specifike në burgje si dhe hulumtimi lidhur me disa indikator	5
4. Kujdesi farmaceutik për të gjithë të burgosurit falas sipas LESPK dhe Ligjit për Shëndetësi në Kosovë dhe rregulloret e AKPM-se	5
5. Mbajtja dhe monitorimi i kushteve higjienike sanitare në burgje	6
6. Menaxhimi i mirë i stafit shëndetësor të burgjeve	6
7. Monitorimi i aktiviteteve dhe shërbimeve të cilat përcaktojnë kualitetin e kujdesit shëndetësor	7
II. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve. 12	
Integrimi i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë	12
Buxheti dhe menaxhimi i tij	12
III. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në vend dhe jashtë	13
IV. Monitorimi i cilësisë dhe ankesave të të burgosurve dhe ndërmarrja e masave adekuate 13	
V. Implementimi i Sistemit Informativ Shëndetësor në burgje	14
VI. Përpilimi dhe harmonizimi me BE i protokolleve dhe proceduarve të DShB	14
VII. Vështirësitë dhe mungesat	15
VIII. Synimet	17
IX. SHTOJCAT	17

HYRJE

Qëllimet kryesore të Departamentit Shëndetësor të burgjeve për vitin 2017 janë:

- 1. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje*
- 2. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve*
- 3. Monitorimi i cilësisë dhe ankesave të të burgosurve dhe ndërmarrja e masave adekuate*
- 4. Implementimi i Sistemit Informativ Shëndetësor në burgje*
- 5. Përpilimi dhe harmonizimi me BE i protokolleve dhe proceduarve të DShB*

Ne vazhdim është paraqitur realizimi i planit të punës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017 sipas qëllimeve dhe planit të punës:

I. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje

1. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së kujdesit shëndetësor

- Në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje kanë funksionuar në mënyrë të pandërprerë dy komisione; komisioni për monitorim të punës së NjShB dhe Komisioni për shqyrtim të të gjitha ankesave të të burgosurve. Si rezultat i kësaj janë edhe raste evidente, masat dhe propozimet për komisione disiplinore për disa pjesëtar të stafit.
- Janë dërguar informata dhe sqarime për proceduar të ndryshme dhe janë monitoruar respektimit të tyre në dobi të shëndetit të të burgosurve.
- Kemi bashkëpunuar me Avokatin e Popullit dhe mekanizmin për parandalimin e torturës, me KMDLNJ dhe Këshillin e Evropës. Kemi pasur kërkesa indirekte por jo direkte nga QKRMT për bashkëpunim.
- Po ashtu kemi kërkuar nga QMPT “Labirint” mbështetje për trajtimin e të burgosurve dhe trajnimin e stafit për parandalimin e vete lëndimeve dhe vetëvrasjeve.
- Shërbimet Shëndetësore në burgje janë monitoruar edhe nga Inspektorati Sanitar, dhe nga Auditori i përgjithshme. Jemi duke bërë përpjekje për trajnim të Inspektorateve për specifikat e punës së DShB në funksion të monitorimit të vazhdueshëm profesional.
- Kemi shprehur gatishmëri për bashkëpunim me OJQ të ndryshme në funksion të mbështetjes, monitorimit dhe donacioneve të ndryshme por vetëm përmes marrëveshjeve të qarta dhe profesionale.

2. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mjekësor të burgjeve

- Në këtë periudhë ka vazhduar trajnimi edhe i **20 infermiereve** tjerë të DSHB në Qendrat Trajnuese të KPSH si: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Peje, Istog dhe Mitrovicë. Trajnimi në modulën e parë është kryer, ndërsa në muajin Tetor do të vazhdojë edhe në dy module tjera.

- Ne muajin Maj, gjegjësisht me datat 04, 05, 15 dhe 16 .05.2017 , ne QK Lipjan dhe Burgun e Dubraves është kryer trajnimi i **104 pjesëmarrësve (mjek dhe infermier)** ne fushën e RKP dhe përdorimit te defibrilatorit mobil.
- Me datën 27.06.2017 deri me 06.07.2017, është mbajtur trajnimi për Trajtimin e Përdoruesve te Drogave nga Colombo plan – drug advisory program , ku **4 pjesëmarrës** kane qene nga DSHB.

3. Kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm për te gjithë te burgosurit pa dallim ne nivel te njëjtë sikur për qytetaret e tjerë ne sistemin publik shëndetësor

- Ka vazhduar shërbim infermierie 24 ore ne te gjitha NjShB-të.
- Ne te gjitha NJShB –te ka pasur mjeke çdo dite pune dhe ne thirrje, ndërsa ne stacionarin e Burgut te Dubraves ka pasur shërbimi mjekësor 24 ore.
- Ne Stacionarin e Burgut për Siguri te Larte ka pasur mjek çdo dite me mbulim te shërbimit prej 12 orëve dhe ne thirrje.
- Ofrimi i shërbimeve konsultative te përcaktuara ne UA 05/2014 sipas lemive dhe NJShB –ve ne bashkëpunim me ShSKUK ka funksionuar mjaft mire në këtë periudhë. Kemi shtuar numrin e konsultanteve ne BSL ne Gerdovc një kardiolog dhe një kirurg ne SB te Dubraves. Kemi arrite që pagesat të behën me rregull nga buxheti jonë këtë vit.
- Kemi angazhuar edhe Radiologun për mamografi dhe ultrazë te femrave ne QK ne Lipjan
- Njësia psikiatrike në Stacionarin e burgut te Dubraves ka funksionuar sipas një plani te veprimit i cili është monitoruar ne vazhdimësi.
- Jemi duke mbikëqyrur implementimin e planit dhe procedurave për parandalimin e vetëvrasjeve ne burgje.
- Se bashku me ShKK kemi themeluar komisionin multidisciplinar për parandalimin e vetëvrasjeve dhe menaxhimin e rasteve vështirë te menaxhueshme. Kemi hartuar dhe funksionalizuar edhe Rregulloren e punës se këtij komisioni. Ky komision ka ndikuar mjaft ne zvogëlimin e ankesave dhe ne adresimin e problemeve te cilat kane qene multidisciplinare.
- Kemi vazhduar scringun lidhur me parandalimin e sëmundjeve kancerogjene te mitrës duke bere PAPA testin për te gjitha femrat e burgosura.
- Kemi vazhduar scringun e kancerit te mameve përmes mamografise për te gjitha te burgosurat femra.
- Kemi angazhuar edhe konsultat dermatovenerolog për vizite sistematike te te burgosurve dhe trajtim te te gjitha kondilomave dhe sëmundjeve te tjera te lëkurës dhe veneriane.
- Kemi vazhduar shërbimin stomatologjik ne te gjitha burgjet ku ka hapësirë, ndërsa aty ku nuk ka hapësirë, te burgosurit dërgohen burgun me te afërt. Ne te gjitha burgjet ka karrige stomatologjike dhe pajisje e material për trajtim te dhëmbit.
- Kemi aktivizuar laboratorin ne te gjitha burgjet dhe jemi duke kryer shërbime edhe ne ato burgje ku nuk ka ende pajisje laboratorike.
- Ne burgun e Dubraves kane funksionuar RTG-te.

4. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe kuantitative specifike ne burgje si dhe hulumtimi lidhur me disa indikator

- Ka vazhduar pa ndërprerë, raportimi i rregullt, monitorimi, parandalimi dhe trajtimi i sëmundjeve jo infektive, infektive, dhe epidemive eventuale.
- Ka vazhduar pa ndërprerë, monitorimi dhe trajtimi i disa indikatorëve specifik ne burgje; vete lëndimet (86), lëndimet trupore (146), abuzimet seksuale (0), grevat e urisë (45) tentim vetëvrasjet (19), vetmit (141) dhe vdekjet (2).
- Ka vazhduar projekti dhe është bërë menaxhimi i HIV/AIDS, TBC, HCV, HBV dhe drogat - Parandalimi, edukimi shëndetësor, trajtimi dhe rehabilitimi përmes, Testimit vullnetar, trajnimit te stafit dhe te burgosurve, arritshmeria e te burgosurve për ti informuar lidhur me parandalimin ka qene 100%, shpërndarja e kondromave.
- Ka vazhduar programi i metadonit ne burgje. Ne këtë fazë kemi 5 persona në program.
- Sa i takon TBC, kemi pasur bashkëpunim me FG si ne furnizim me barëra, ashtu edhe ne trajnim te stafit, renovim te njësisë për izolime për shkaqe shëndetësore. Kemi pasur edhe takime me përfaqësues te OBSH-se dhe FG lidhur me këtë projekt.
- Trajtimet psikiatrike ne institucione te specializuara, bashkëpunimi me IKPFK (Institutin Kombëtare te Psikiatrisë Forenzike te Kosovës) ka vazhduar.
- Kemi organizuar vizita shtese sistematike jashtë rutine te analizave laboratorike, se paku një here ne vit për te burgosur; vizita sistematike stomatologjike; vizita mamografie dhe PAPA test për femra; projekt për trajtimin e përbormit te drogave dhe parandalimit te vetëvrasjeve, ne harmoni edhe me OJQ te ndryshme, etj.
- Ne funksion te transparencës se mjaftueshme, te gjitha aktivitetet i kemi publikuar ne web faqe te Ministrisë.

4. Kujdesi farmaceutik për te gjithë te burgosurit falas sipas LESPK dhe Ligjit për Shëndetësi ne Kosove dhe rregulloreve te AKPM-se

- Kemi kontrata valide për te gjitha produktet farmaceutike te nevojshme.
- Gjate kësaj periudhe jane shpallur dhe perfunduar edhe pse me vonesa 4 kontrata.
- Është bere furnizimi me barëra dhe material mjekësor për te gjitha institucionet ne mënyrë te vazhdueshme, periodike.
- Kemi bere furnizimin e burgjeve me barëra dhe material mjekësor ne periudhën e pare ne shume prej **rreth 60,000.00 €**.
- Ne total burgjet janë furnizuar me rreth **700 artikuj** te cilët janë ne listën e barërave ne burgje.
- Kjo liste është hartuar nga komisioni multidsiciplinar për barërave për burgje sipas nevojave, indikacioneve dhe zhvillimeve tekniko teknologjike.
- Po ashtu ka vazhduar pa ndërprerë monitorimi i vazhdueshëm i shpenzimeve përmes vizitave dhe sistemit elektronik si dhe monitorimi i mënyrës se përshkrimit.
- Janë hasur vështirësi ne disa artikuj te cilët rralle shfrytëzohen ne burgje dhe te cilët nuk janë as ne listën e DShB e as ne atë te MSh. Disa nga këta artikuj i kemi proceduar me proceduar te veçanta te prokurimit ndërsa disa janë detyruar te sillen ne forma te ndryshme, edhe përmes familjareve.

- Menaxhimi i barërave është bere mire nga stafi dhe rralle shume janë gjetur apo keqpërdorur barëra nga te burgosurit.
- Janë monitoruar implementimet e procedurave te nevojshme për mënyrën e menaxhimit te barërave ne burgje.

5. Mbajtja dhe monitorimi i kushteve higjienike sanitare në burgje

- Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve higjienike sanitare punëtoreve dhe burgjeve ka vazhduar sipas ligjit. Nuk ka pasur ndonjë epidemi brenda burgut përkundër gjendjes se përgjithshme ne vend qe ka pasur epidemi.
- Ka vazhduar pajisja me librezat sanitare për punëtor shëndetësor sipas planit për te gjithë stafin mjekësor dhe punëtorët e kuzhinës, spitalit dhe lavantarise, qofshin te burgosur ose korrektues.
- Nga ky vit, DShB përcjell dhe mbështet financiarisht vetëm kontrollimet sanitare te Stafit shëndetësor, ndërsa atë korrektues dhe te kuzhinës e bene ShKK.
- Është bërë aplikimi i DDD në të gjitha burgjet dy here d eri me tanine harmoni me nevojat dhe kushtet epidemiologjike e klimatike ne vend ne funksion te parandalimit te përkeqësimit te gjendjes epidemiologjike.
- Ne asnjë burg nuk ka pasur brejtës, insekte apo milingona.
- Disa objekte ne burgje janë te vjetruara dhe kane defekte dhe këto shpesh po ndikojnë ne kushte jo te mira higjienike ne ato burgje
- Ne BSL, stacionari është c`vendosur ne katin e pare si pasoje e dëmtimit te dyshemesë ne atë institucion.

6. Menaxhimi i mire i stafit shëndetësore te burgjeve

- Kemi bere regrutimin e stafit për pozitat e zbrazëta (1 infermier); ndërsa jemi ne procedure për plotësimin një pozite për psikolog, konkurs i cili ka dështuar.
- Është duke u bërë edhe trajnimi i stafit dhe aplikimi i të gjitha masave sipas UA 05/2014.
- Janë zhvilluar edhe procedurat disiplinore për 3 punëtor shëndetësor sipas raportimeve nga eproret e tyre.
- Kemi bere pezullimin e një infermieri ne Dubrave deri sa te zhvillohen procedurat disiplinore.
- Nuk kemi arritur as ne këtë periudhe te implementojme rrezikshmërinë për stafin shëndetësor.
- Me mbështetjen e Ministrit, janë duke vazhduar specializimet 15 mjek te DShB-se
- Janë paguar te gjitha shërbimet e stafit si kujdestarit, ndërrimet e natës, festa dhe konsultonte.
- Ka përfunduar vizita sistematike e te gjithë stafit shëndetësor te burgjeve dhe tani jemi duke bashkëpunuar me Institutin e Mjekësisë se Punës ne Gjakove për te lëshuar certifikatat e gjendjes shëndetësore te te punësuarve.


7. Monitorimi i aktiviteteve dhe shërbimeve të cilat përcaktojnë kualitetin e kujdesit shëndetësor

- Ka vazhduar monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore dhe indikatorëve të veçante që e përcaktojnë kualitetin e gjendjes shëndetësore dhe shërbimeve shëndetësore përmes kontrollimit të rreptë të raportimeve periodike dhe të rasteve, përpunimi i të dhënave, rezultateve të trajnimit të stafit etj.
- Inspektimi i rregullt në fushën sanitare, shëndetësore, farmaceutike të NJShB-ve.
- Përpjekjet për implementimi dhe monitorim të aktiviteteve përmes SISh si metode më të avancuar të monitorimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe kualitetit të tyre.
- Është ripërsëritur draft projekti për IPA projekt lidhur me Institucionit për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta dhe është prezantuar projekti para donatoreve, pritet reflektimi dhe rezultatet eventuale.
- Kane përfunduar në këtë periudhë këto aktivitete shtese shëndetësore në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje:
 - Vizita sistematike stomatologjike, u janë kryer **1103 të burgosurve** (BSL -158, QKL - 85, QP Prizren - 64, QP Lipjan - 93, QK Smerkonice - 103, B.Dubrave - 600).
 - Mamografia, 11 të burgosurve ju janë kryer, 5 refuzime.
 - Papa test, 9 të burgosurve ju janë kryer, 12 refuzime.
 - Analiza laboratorike, u janë kryer **531 të burgosurve** (B. Dubrave - 400, BSL - 54, QK Smerkonice- 60, QK Lipjan -17)

Bazuar në këtë monitorim dhe raportim, për periudhën gjashtëmuajore kanë rezultuar këto shërbime të kryera:


- Janë kryer 2,159 vizita të para mjekësore me hapje të dosjes mjekësore.
- Janë kryer 2,150 vizita të fundit liruese mjekësore.
- Janë kryer gjithsejtë 17,594 vizita mjekësore.
- 1,767 konsultime psikiatrike
- 1,598 konsultime psikologjike
- 2.109 vizita dhe trajtime stomatologjike.
- 6,663 shërbime të tjera jo specifike.
- Në total janë kryer 28,307 shërbime mjekësore. Që mesatarisht i bie secili i burgosur është vizatuar se paku **13 here** nga mjeku gjatë vitit

Grafë numër 1, shërbimet shëndetësore të përgjithshme gjatë kësaj periudhe



Për trajtim adekuat ka qenë e nevojshme edhe hospitalizimi në Stacionarin e burgut në Dubravë ku gjithsejtë ka pasur 55 sosh, ndërsa në spitale civile janë hospitalizuar 75 të burgosur (3.96%). Për intervenime te ndryshme, jahte burgjeve, janë dërguar 93 te burgosur. Për konsultime jashtë Institucioneve Korrektuese janë dërguar 990 raste (45.85%)

Grafi numër 2, Lëvizjet e te burgosurve jashtë burgjeve për shërbime shëndetësore gjate kësaj periudhe




Sa i përket 10 sëmundjeve te cilat përcillen vazhdimisht ne institucionet korrektuese gjendja ka qenë si vijon:

- Neuroza 1,332 raste
- Psikoza 264 raste
- Çrregullime kardiovaskulare 790 raste
- Çrregullime respiratore 1,290 raste
- Çrregullime gastrointestinale 982 raste
- Çrregullime urogjenitale 449 raste
- Sëmundje te lëkurës 470 raste
- Sëmundje seksualisht te transmetueshme 6 rast

- Sëmundje te traktit lokomotor 1,109 raste dhe
- Sëmundje infektive te ndryshme 76 raste.


Grafi numër 3, Dhjete sëmundjet e ndryshme qe përcillen vazhdimisht ne burgje paraqitur gjate kësaj periudhe



Gjate kësaj periudhe janë evidentuar dhe menaxhuar edhe këta indikatorë:

- Vetëlëndimet, 86 raste
- Lëndimet trupore, 146 raste
- Abuzimet seksuale, 0 rast të raportuara
- Rastet ne greve te urisë 45 raste
- Tentim vetëvrasje 19 raste të raportuara
- Vetmia, izolime kane qene 141 raste
- Vdekjet në burg, 2 raste.


Grafi numër 4, shtate indikatorët shëndetësor gjate kësaj periudhe



Ne periudhën e pranimit janë identifikuar

- 1,103 duhanpirës janë pranuar ne burgje ne këtë periudhe (59%)
- 197 përdorues te alkoolit (10.05%)
- 201 përdorues te drogave (10.72%)
- 40 raste me diabet (2.13%)
- 105 raste me hipertension (5.6%)

Grafi numër 5, paraqitja e duhan pirjes, përdorimit alkoolit dhe te drogave gjate kësaj periudhe




Me poshtë, ne tabelën numër 1, po ju prezantojmë disa indikatorë specifik:

Tabela numër 1, duhanit, alkoolit, drogave, rastet me Hepatit dhe indikatorë teje gjate kësaj periudhe sipas NjShB-ve

DEPARTAMENTI SHENDETESOR I BURGJEVE													
RAPORTI GJASHEMUJORIT TE PARE TE VITIT 2017 PER DISA INDIKATORE													
Nr	Lloji i të dhënave	Dubrava	Q.K.L	Q.P.L	Smrek.	B.S.L	Peja	Prizreni	Qek	Gjilani	Mitrov.	Totali	Perqindja
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	750	113	180	165	27	190	272	0	140	38	1875	100
2	Numri i duhangjinjeve	419	73	120	89	11	115	184	0	68	24	1103	59
3	Numri i abuzuesve të alkoolit	75	7	5	6	0	44	18	0	26	16	197	10.05
4	Numri i abuzuesve të drogave	53	10	19	11	1	39	41	0	16	11	201	10.72
5	Rastet me Hepatitit	5	2	3	1	0	0	0	0	1	1	13	0.69
6	Rastet me TBC	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Rastet me Diabet	13	4	5	12	1	0	0	0	3	2	40	2.13
8	Rastet me SST (AIDS)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Rastet me Hipertension Arterial	28	1	15	39	4	4	2	0	5	7	105	5.6

Bazuar ne këtë tabelle, vërehet se ka vazhdim te rritjes se përqindjes se përdoruesve te drogave ne burgje.


Grafi numër 6, ecuria e përqindjes se përdoruesve te drogave ne katër vitet e fundit




Sa i takon tri sëmundjeve specifike dhe ku te burgosurit karakterizohen si kategori e rreziku, kemi pasur këtë ecuri:

- HBV dhe HCV 13 raste.
- TBC 0 raste te ardhura me infeksion (ka rënie te kësaj sëmundjeje).
- HIV/AIDS 1 raste.
- Nuk ka pasur asnjë epidemi gjate kësaj periudhe.

Grafi numër 7, TBC Hepatiti dhe HIV gjate kësaj periudhe



Grafi numër 8, ecuria e TBC ne burgje ne katër vitet e fundit



II. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve

Integrimi i Departamentit Shëndetësor te Burgjeve ne kuadër te Ministrisë se Shëndetësisë

- Është vazhduar integrimi i te gjitha shërbimeve shëndetësore dhe është duke u arritur ofrimi i kujdesit shëndetësor ekuivalent për te burgosurit sikurse për qytetaret e tjerë. Është duke vazhduar respektimi MM me ShSKUK për shërbime të përbashkëta, përfshirë konsultantët, mbështetjen më kontratë dhe në funksionalizimin e dhomave të sigurta dhe rasteve psikiatrike.
- Ka ende vështirësi, përkundër përparimeve për funksionalizimin e dhomave te sigurta.
- Ne nga ana e jon për këtë qellim kemi caktuar një infermiere e cila është duke i bere përcjelljen e te burgosurve te hospitalizuar dhe caktimin e terminëve te tyre ne funksion te zvogëlimit te humbjes se kohës, racionalizimit te daljeve dhe ofrimin te shërbimit me te sakte dhe me kohe.
- Në MSh ka pasur mbështetje në lehtësimin e procedurave dhe mbështetje të shërbimeve për DShbB-në.
- Kemi pasur edhe mbështetje financiare nga MSh, gjegjësisht AFSh per blerje te reagensëve.

Buxheti dhe menaxhimi i tij

- Për vitin 2017 është aprovuar buxheti prej 1,309,431.31€ (Paga dhe mëditje 1,027,431.31€, Mallra dhe shërbime 2780,000.00 €, ndërsa Komunali 2,000.00 €).

- Ky buxhet është zvogëluar nga MF pa asnjë shpjegim dhe nuk mjafton për shërbimet shëndetësore të burgjeve.
- Ne kemi shpenzuar rreth 70 % të buxhetit të caktuar. I tere shpenzimi ka shkuar sipas planifikimit.
- Kemi pasur mbështetje për disa aktivitete nga MSh, si barëra, komunal, shpenzime të derivateve dhe vetura për funksionim adekuat.

III. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në vend dhe jashtë

- Bashkëpunim të mirë dhe mirëkuptim kemi pasur edhe me Ministrinë e Drejtësisë.
- Ka vazhduar bashkëpunimi i mirë me Shërbimin Korrektues të Kosovës (Drejtorinë Qendrore dhe Drejtorët e burgjeve), dhe Drejtorët e burgjeve. Bashkëpunimi ka qenë korrekt profesional dhe i dy anshëm. Fërkimet kanë qenë minimale dhe të tej kalueshme.
- Bashkëpunimi ka ekzistuar edhe me Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Ombudspersonin, Këshillin e Evropës dhe EULEX në funksion të harmonizimit të shërbimeve duke rritur cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe duke ruajtur autonominë profesionale, përmes takimeve të përbashkëta, menaxhimit të rasteve bashkërisht dhe harmonizimit të dokumentacioneve të punës dhe transferim të të burgosurve.
- Bashkëpunim kemi pasur edhe me OJQ-te interesuara për bashkëpunim. Në këtë fushë jem të hapur që edhe në të ardhmen të bashkëpunojmë në mënyrë profesionale dhe në dobi të shërbimit dhe shëndetit të të burgosurve.

IV. Monitorimi i cilësisë dhe ankesave të të burgosurve dhe ndërmarrja e masave adekuate

- Gjate kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha ankesat e të burgosurve në dy forma; nga komisioni i ankesave dhe nga komisioni multidisiplinar i themeluar bashkërisht me ShKK.
- Këto komisione kanë dhënë rezultatet e vete duke zvogëluar numrin e ankesave dhe njëherësh duke evidentuar mangësitë në funksionim të sistemeve në funksion të përmirësimit të tyre.
- Janë shqyrtuar gjithsej 17 ankesa të të burgosurve të marra qofte në kutitë e ankesave qofte nga ankesat përmes mekanizmave të tjerë.
- Është themeluar dhe ka funksionuar Komisioni etik i DShB-se.
- Ka funksionuar edhe komisioni disiplinor i cili ka ndikuar në shqyrtimin e rasteve individuale të keqfunksionimit apo dyshimit në neglizhencë në punë.

V. Implementimi i Sistemit Informativ Shëndetësor ne burgje

- Implementimi i SISH ne burgje është ende i pa kompletuar. Përkundër asaj se ia kemi vendos obligim vetes per funksionalizim te plote, ende nuk kemi arritur ta funksionalizojme plotësisht:
 - 1) Se pari, ka mungese rrjeti ne disa institucione dhe përkundër përpjekjeve me ShKK dhe MAP, ende ka institucione pa rrjet (Dubrava), ndërsa ne institucionet e tjera rrjeti është i dobët.
 - 2) Se dyti, si pasoj e rrjetit, edhe stafi ka qene jo insistues qe te shfrytëzoj momentet e punës se rrjetit.
 - 3) Se treti, edhe mbështetja e SISH ka qene e limituar dhe jo mbështetës ne realizimin e projektit duke mos qen e gatshme për te mbështetur stafin në vendin e punës gjegjësisht ne kërkesat dhe vështirësitë e tyre.
 - 4) Se katërti, projekti edhe ashtu nuk na ka ofruar ndonjë dobi ose përfitim ne përpunimin e te dhënave, edhe kur kemi pasur nevojë dhe,
 - 5) Se pesti, softueri nuk është kompatibil me specifikat e burgjeve përkundër kërkesë sonë dhe insistimit si ne draftin te projektit edhe ne fazën e implementimit.

VI. Përpilimi dhe harmonizimi me BE i protokolleve dhe proceduarve te DShB

Përpilimi dhe përfundimi i dokumentacionit legjislativ dhe proceduarve te punës

- Kemi vazhduar Projektin me Këshillin e Evropës për Protokolle, proceduar dhe te drejta te njeriut.
- Lanësimi i projektit është bere me 07 Nëntor 2016 dhe ka vazhduar gjate këtij gjashtëmujori me intensitet te shtuar.
- Jemi anëtar te Komitetit Drejtues te Projektit.
- Përpos te tjerash, ne këtë projekt deri me tani ka pasur keto zhvillime:
- Ka përfunduar faza e pare e Projektit me Këshillin e Evropës lidhur me Harmonizimin e proceduarve te Punës se DShB me ato te Këshillit te Evropës.
- Punëtorja e fundit e mbajtur me 28 dhe 29 qershor ka përfunduar me harmonizimin e te gjitha proceduarve te punës nga grupi punues i DSHB dhe atij te Ekspertëve te Këshillit te Evropës.
- Ne vazhdim ka mbetur edhe konfirmimi me shkrim i Ekspertëve lidhur me këtë harmonizimi i cili do te qel rrugën e zyrtarizmit përfundimtar te te gjitha proceduarve te punës dhe përshkrimeve te vendeve te punës për te gjitha pozitat ne DShB.
- Menjëherë, posa te marrim këtë konfirmi tanimë formal, ne do te ju njoftojmë ne detaje me te gjitha procedurat e harmonizuar; Ne këto proceduar përfshihen:
 1. Procedurat e punës (12 procedura),
 2. Menaxhimi i indikatorëve specifik ne burgje (5 indikatorë)
 3. Menaxhimi i barërave ne burgje (3procedura
 4. Përshkrimi i detyrave te punës (30 pozitat ekzistuese te DShB),

5. Proceduarat e trajtimit me Terapi Mbajtëse ne Burgje,
 6. Kriteret për hapësira dhe pajisje ne DShB sipas kriterëve vendore dhe ne harmoni me ato te KE.
- Faza e Dytë ka te beje me trajnimin e stafit lidhur me këto proceduara.
 - Ka përfunduar trajnimi i tere stafit lidhur me ndihmën e pare dhe ky trajnim është certifikuar nga BEVM dhe eshët bere furnizimi i te gjitha NjShB me pajisje te nevojshëm për ndihem te pare. Secila ambulance e burgut nder te tjera ka Defibrilator dhe secili pjesëtar i stafit mjekësorë është trajnuar për përdorimin e tij.
 - Ka përfunduar edhe trajnimi lidhur me parandalimin e vetëvrasjeve ne burgje,
 - Janë krijuar 5 grupe punuese për trajnim dhe implementim te këtyre çështjeve:
 1. Grupi punues për PSO
 2. Grupi punues për çështje etike
 3. Grupi punues për sëmundjet infektive
 4. Grupi punues për programet e trajnimeve
 5. Grupi punues për Shëndetin Mendor
 - Anëtarët e grupeve punuese do te jen Trajner te Trajnerëve dhe pastaj do te bëjnë trajnimin e stafit mjekësorë dhe atij jo mjekësor ne burgje.
 - Do te realizohet edhe një vizite studimore, organizuar nga KE.
 - Do te behet monitorimi i implementimit te këtyre indikatorëve dhe proceduarve.
 - Tere kjo do te kërkojmë qe te mbikëqyret nga Zyra e Avokatit te Popullit, gjegjësisht Mekanizmit Koordinues për Parandalimin e Torturës ne kuadër te këtij institucioni, KMLDNJ-se dhe Organizatave te tjera te interesuar dhe te cilat shprehin interesim për këtë çështje përmes proceduarve te rregullta te parapara me rregulloret e punës ne fuqi.
 - Me këtë akt po plotësohen detyrimet te cilat dalin nga UA05/2014 te QRK sa i takon çështjes se legjislacionit dhe proceduarve.
 - Tere kjo është realizuar duke iu falënderuar Zyrës se Këshillit te Evropës ne Kosovë, gjegjësisht Zonjën Gallucci dhe stafin e saj, për mbështetjen e jashtëzakonshme, për fondet, përzgjedhjen e ekspertëve te dalluar si dhe mundësin qe te arrijmë standarde ndërkombëtare ne këtë faze kur ne kemi bërë transferin nga MD ne MSh dhe kemi instaluar praktikë te re ne Evropën Juglindore ne dobi te funksionalizimit te shëndetësisë se pavarur dhe profesionale ne burgje.

VII. Vështirësitë dhe mungesat

1. Mungesa e Institucionit për Trajtimin e Personave me Nevoja te Veçanta ne Burgun e Dubraves si pjese e parapare me Ligjin për shëndetësi. Është dorëzuar projekti edhe ne IPA këtë periudhe.
2. Mangësitë ne sektorin publik shëndetësor te reflektuar ne vështiruesit e menaxhimit te rasteve.
3. Dhomat e sigurta janë përfunduar dhe ka filluar implementimi i funksionimit te tyre por janë hasur vështirësi për shkak te mungesës se stafit infermierie për ato dhoma.

4. Dëmtimet fizike te objekteve te banimit ne burgje dhe po ashtu ato ne ambulanca dhe stacionar si dhe mirëmbajtja dhe renovimi i tyre po shkaktojnë vështirësi ne cilësinë e shërbimeve shëndetësore.
5. Vonesat ne implementimin e rrezikshmërisë se stafit e cila do te kompensonte ne një forme punën specifike dhe me presione e rrezik permanent.
6. Stafi jo i mjaftueshëm për mbulimin e te gjitha shërbimeve te domosdoshëm. Ne kemi kërkuar ne planet dhe projeksionet e buxhetit për vitin 2017, 2018 dhe 2019 qe te na shtohen numri i stafit ne vazhdimësi, mirëpo nga MF kjo nuk është aprovuar.
 - a. *Vështirësi te mëdha te mbulimit te përhershëm te dy institucioneve me shërbim infermierie 24 orësh.* Me ligjin për buxhet, ne kemi 122 pozita te cilat nuk mjaftojne.
 - b. *Mungese e psikologeve për te mbuluar shëndetin mendor dhe parandalimin e vetëvrasjeve.* Me refuzimin e kërkesës për shtim te numrit te stafit, ne nuk kemi mundësi te mbulojmë katër (4) institucione me psikolog, (Smrekovnice, Peje, Prishtine dhe Mitrovica). Kjo na vështirëson jashtëzakonisht punën ne parandalimin e vetëvrasjeve. Ne këto institucione kemi angazhuar psikiatër konsultant por kjo është e pa mjaftueshme. Ne kemi nevojë edhe për tre (3) psikolog te tjerë për Dubrave, Lipjan për te mitur dhe Gerdovc sepse një psikolog është i pa mjaftueshëm për këto institucione.
7. Buxheti jo i mjaftueshëm dhe i reduktuar. Ne ke mi buxhet te mjaftueshëm per te mbuluar te gjitha nevojat për shërbime, mallra, komunalit dhe staf
8. *Rrezikshmëria refuzohet përkundër bazës ligjore dhe disponueshmerise se mjeteve*
9. *Pamundësia për te pajisur burgjet me mjete te reja diagnostikuese dhe trajtuese si pasoj e mos ndarjes se buxhetit pr kapitale per kodin e DShB.*
10. *Pamundësia e futjes se pagës baze ne formular te MF, ndryshimi i koeficinetve perkunder nevojave dhe kontratave dhe menyra rigide e trajtimit te pagave dhe buxhetit.*
11. *Masa monetare për shërbime dhe mallra zvogëlohet ne vend qe te harmonizohet me nevojat dhe numrin e stafit.* Bazuar ne vet rregulloren e MF ku një punëtor ka 4000€ shërbime dhe mallra, qe për DShB do te ishte minimale 488,000.00€ me çka do te mbulohehin te gjitha shërbimet, përfshirë barërat, pajisjet, DDD, furnizimet për zyre, karburante dhe te gjitha kategoritë e tjera te parapara ne formularë, neve na janë aprovuar nga 290,000.00€ sa kishim me pare, vetëm 270,000.00€ (qe i bie 218,000.00€ me pak se minimumi sipas kriterit te vet MF).
12. Neglizhenca dhe zhegjitjet e proceduarve te prokurimit ne MSh. Po ashtu tere këtyre vlen te i shtohen edhe disa pengesa administrative te prokurimit, zhagitje te proceduarve e deri ne anulim, disa vonesa ne pagesa te cilat e rendojnë edhe me shume situatën dhe pamundësojnë implementimin e UA 05/2014 te QRK dhe respektimin e te gjitha standardeve te OBSH-se deh KE-se, Rregullave evropiane te burgjeve dhe ngritjen e cilësisë. Shpesh here nuk po kuptohet sakte specifika dhe puna e DShB duke dhënë përgjigje dhe zhvilluar proceduar pa vonesa.
13. Mungesa e dy autoambulancave për transportin e te burgosurve ne nevojë. Ne kemi vetëm një autoambulance transportuese e amortizuar ne Dubrave. Me QKMF ne Podujevë lëmi arritur marrëveshje për mbështetje ne rast nevojë por kjo marrëveshje dhe forme nuk është shume e përshtatshme.
14. Mungesa e veturave për te kryer shërbime mbështetës. Përkundër asaj se një veturë te përdorur kemi marre nga MSh, një nga MD dhe një nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore, ne kemi nevojë për se paku edhe dy vetura. Veturat ekzistues janë te amortizuar dhe po kane prishje te shpeshta dhe shpenzime për servisime po ashtu.

15. Pamundësia e organizimit të trajnimit të organizatave monitoruese të brendshme dhe të jashtme në funksion të njohjes së specifikave të tani edhe proceduarve të punës së DShB në dobi të monitorimit adekuat, profesional dhe cilësor duke avancuar shërbimet përmes vërejtjeve dhe rekomandimeve.

VIII. Synimet

1. Krijimi i kushteve adekuate të favorshme për stafin mjekësor për punë në burgje konform UA 05/2014.
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje dhe qëndrueshmëria e saj përmes trajnimeve, monitorimeve dhe krijimit të kushteve për shërbime cilësore.
3. Zvogëlimi aq sa është e mundur e referimeve të të burgosurve për trajtim jashtë burgjeve duke ofruar shërbime sa më të shumta dhe më cilësore brenda NjShB-ve.
4. Harmonizimi përfundimtar dhe implementimi i protokolleve konform standardeve të BE në funksion të përgatitjes për integrim në BE.
5. Implementimi i protokolleve, proceduarve, hapësirave të punës dhe pajisjeve për punë në Njësitë shëndetësore të burgjeve.
6. Implementimi i SISH në tërësi dhe krijimin e shërbimit për menaxhimin e SISH dhe përpunimin e të dhënave duke mirëmbajtur edhe rrjetin dhe pajisjet në kuadër të DShB
7. Transparenca në vazhdimësi e punëve dhe aktiviteteve në raport me institucionet relevante.
8. Vazhdimi i pa ndërprerë i projektit për shërbime 24 orësh në të gjitha NjShB -te
9. Kyçja e DShB në telemjekësi në SBD .
10. Bashkëpunimi i ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë në të gjitha fushat si dhe bashkëpunimi me Organizatat tjera qeveritare, joqeveritare, lokale dhe ndërkombëtare që merren me shëndetësi në përgjithësi përmes MM precize, profesionale dhe të profilizuara.
11. Vazhdimi i furnizimit të qëndrueshëm në të gjitha institucioneve me barëra dhe material mjekësor.
12. Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve higjienike sanitare në të gjitha institucionet korrektuese
13. Realizimi i krijimit të Institucionit për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta
14. Mirëmbajtja në funksion të dhomave të sigurta në QKUK.
15. Përcjellja e vazhdueshme dhe respektimit të të drejtave të njeriut përmes mekanizmave institucional stabil dhe të përhershëm.
16. Bashkëpunimi dhe trajnimi specifik i organeve monitoruese të Shërbimeve shëndetësore në burgje përmes trajnimit adekuat, profilizimit dhe ndikimit në ngritjen e cilësisë së shërbimeve.

IX. SHTOJCAT

Te bashkangjitur keni edhe:

1. *Planin e punës së DShB për vitin 2017*